



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër 02-04/26
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Leonard Lllolluni - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	30.04.2026
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së katër (4), të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 30.04.2026, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Leonard Lllolluni: i cili në fillim përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, më pas e konstatoi se prezent në sallën e kuvendit janë 14 antaret e Kuvendit të Komunës së Junikut.

Anëtarët prezent

1. Leonard Lllolluni-Kryesues, AAK
2. Bedrush Hoxha-anëtar, LDK
3. Litafete Isufa-anëtare, LDK
4. Shpejtim Gacaferi- anëtar, LDK
5. Sadri Krasniqi- anëtar, LDK
6. Floris Miroci-anëtar, LDK
7. Blerta Sylja-anëtare, LDK
8. Burim Kuçi-anëtar, AAK
9. Ajshe Gacaferi-anëtare, AAK
10. Aldi Gacaferi-anëtar, AAK
11. Arlinda Pepshi-anëtare, AAK
12. Alfred Gaxherri-anëtar, AAK
13. Jetmir Tofaj-anëtar, LVV
14. Elsa Hima-anëtare, LVV
15. Lulzim Gacaferi-anëtar, LVV (**Mungon**)

Rendi i ditës i paraparë

1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Rishqyrtimi i vendimi me nr.2-180/1632, për Komisionin për Themelimi e Këshillave Lolale,
3. Rishqyrtimi i vendimit me nr.2-180/2273, për listën e pronave që Planifikohen të japen në shfrytëzim nga Komuna e Junikut,
4. Rishqyrtimi i vendimit me nr.2-18/1638, për Temelimin e Komiteti për Arsim, Shkenë ,Kultur, Rini dhe Sport,
5. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit të Punës së Kuvendit për Vitin 2026,
6. Shqyrtimi i Raportit Finaciari për Periudhën Janar-Mars 2026,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Inicimit të Procedurave për Plotësim ndryshim të Rregullorës për Taksa Komunale për vitin 2027,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Plotësim ndryshimeve të Rregullorës për Menaxhimin e Mbeturinave (leximi i dytë),
9. Kerkse per vendim per inicim te procedurave per Hartimin e Plani tre Vjeçar për Banim social (2026-2029)
10. Të ndryshme

Rendi i ditës i parapar per mbledhjen e sotit u miratua me 14 vota per, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim.

z.Leonard Lllolluni, kemi nje kerkes nga UD i drejtoris per shendesi qe si pike e nente (9) te hynë kerksa per inicim te procedurave per Hartimin e Plani tre Vjeçar për Banim social (2026-2026) kush eshte per qe kjo te hynë ne rend te ditës per shqyrtim, per 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se kërkesa per te hyre ne rend te ditës u miratua.

1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, përshëndetje per te gjithë, nuk kam diçka lidhur me procesverbalin , por me proceduart e rendit te ditës meqë nuk mu dha fjale, ne baze te proceduarve ne gjithemone kemi me mare fjale, por jo me mare fjalën pa na u dhanë nga kryesuesi i kuvendit, dhe sipas procedurave dhe rregullores se kuvedit anjehere nuk duhet te qitet ne votim rendi i ditës pa u dhene shpjegime, fillimishte ftohen shefat e grupeve te partive te përfaqësuar ne kuvend, nëse nuk e marin fjalën shefate e grupeve atëherë munden anetaret e tjerë te kuvendity te debatojnë, kete deshta ta sqaroj.

z.Leonard Lllolluni, kerkese nuk ka, e qes ne votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar, kush eshte per, per 14 vota, kundër 0 bota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procevrwali i mbledhjes se kaluar u miratua.

2. Rishqyrtimi i vendimi me nr.2-180/1632, për Komisionin për Themelimi e Këshillave Lolale,

Sqarimin e rishqyrtimit te vendimt me nr: 2-180/1632 e beri kryesuesi i kuvendit z.Leonard Lolluni.

z.Burim Kuçi, përshëndetje per te gjithë, me qene se qenka ne pyetje kot gjinore ne si AAK e propozojmë z.Arlinda Pepshi.

z.Shpejtim Gacaferi, ne z.Sadri Krasniqi e zavedsojme me z.Litafete Isufaj.

z.Leonard Lolluni, me qe i kemi këto dy propozime une e qes ne votim rishqyrtimin e vendimit, kush eshte per, per 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rishqyrtimi i vendimit me nr:2-180/1632 per komisioni per themelimin e këshillave lokale u miratua.

3. Rishqyrtimi i vendimit me nr.2-180/2273, për listën e pronave që Planifikohen të japen në shfrytëzim nga Komuna e Junikut,

Sqarimi e rishqyrtimint te vendimit me nr:2-180/2273 e beri kryesuesi i kuvendit z.Leonard Lolluni.

Votimi, per 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatohet se rishqyrtimi i vendimti me nr:2-180/2273 u miratua.

4. Rishqyrtimi i vendimit me nr.2-18/1638, për Temelimin e Komiteti për Arsim, Shkenë ,Kultur, Rini dhe Sport,

Sqarimin e rishqyrtimit te vendimt me nr:2-180/1638, e beri kryesuesi i kuvendit, z.Leonard Lolluni.

z.Shpejtim Gacaferi, na dhatë shpjegimin se pse nuk e ka kaluar ligjshmërinë, por përkundër kësaj kerkoje sqarim me te hollsishme, a sugjerohet edhe diçka tjetër, dhe a ka vrejtje ministria e linjës lidhur me kete vendim apo eshte vetëm ajo qe i mungon emri nga radhët e LDK_se, do ishte mire qe sqarimi te ipet deri ne funde sepse une nuk kame material per kete qeshtje.

z.Bedrush Hoxha, përshëndetje per te gjithë, e ka me te drejte z.Shpejtim Gacaferi, ligjshmëria e keti vendim nuk ka te beje vetëm me mos propozimin e anëtarit nga radhët e LDK_se, per kete qeshtje kemi diskutuar edhe ne mbledhjen e KPF_se, dhe aty lidhur me kete vendim ma dhene sqarim edhe drejtoresha e administratës znj.Leonora Shehu,

z.Jetmir Tofaj, përshëndetje per te gjithë, fillimisht une dua te ju kërkoj falje juve kryesues, sepse ne mbledhjen kur eshte mare vendimi ju keni dashtur te vazhdoni me propozime me emra konkret dhe jame une qe anëtari i LDK_se te mbetet ashtu vetëm e vetëm qe ky komitet te kete perfaqsim nga te triat subjekte qe perfaqsonje Kuvendin e Junikut, por eshte dashur te lejoj qe te kemi propozime tjera ate dite, andaj per kete kërkoj falje.

z.Leonard Lolluni, sa per sqarim ligjshmëria per kete vendime eshte kthyer vetëm per nje arsye qe nuk ka emerm te perfaqsimi nga radhët e LDK_se, dhe nëse nuk ka propozim nga radhët e LDK_se ne duhet ti ndërmarrim masat o per shfuqezim te vendimit o te kemi nje propozim tjetre.

z.Ruzhdi Shehu-Kryetar i Komunes se Junikut, pershnedetje per te gjithë, me qene se u sqarua, nuk eshte vetëm perfaqsimi i LDK_se , por edhe pe rate se nuk eshte komitet obligativ, por edhe per kundër kësaj ky komitet nuk i ka kapacitete qe mund ta kishin dhene rekomandime sa i perkete zhvillimit te arsimit apo cilsine. Sa i perkete zhvillimit dhe cilsis se arsimit ne kemi monitorim nga niveli qendrosr por edhe nga inspektorati i arsimit ne Peje, andaj kerkoje mirëkuptim nga te gjithë bashkarishte, dhe ne mbledhjen e KPF_se jemi dakortuar te gjithë qe ky vendim te shfuqizohet.

z.Bedrush Hoxha, pikerishte kete e thash se ne mbledhjen e KPF_se jemi dakorduar te gjithë edhe z.Jetmir Tofaj qe ky vendim te shfuqizohet, sepse nuk ka edhe baze ligjore, po ashtu edhe ti kryesues ke qen per, andaj kisha kërkua qe venimin e ministris perkatse ta lexojsh deri ne fund.

z.Leonard Lolluni, une kam qene per qe çdo vendim qe na kthehet per rishqyrtim me e sjelle ne kuvend , andaj une isha per qe me sjelle per shqyrtim ne kuvend, dhe ktu ne kuvend e mer epilogun, sa per ligjshmëri, ky vendim ka ligjshmëri por eshtek ther per rishqyrtim pasi qe ka munguar emërtimi i anëtarit nga ana e LDK_se.

z.Jetmir Tofaj, nuk jemi dakorduar qe te shfuqizojmë vendimim ne mbledhje e KPF_se, ekziston procesverbali i kësaj mbledhje, une ate dite nuk jame bere pjese e diskutimit , thjeshte kemi votuar per te sjellur ne kuvend per rishqyrtim, nuk eshte mire te nxitohet me konkludime te tilla, se propozimi eshte i LVV-se, do ishte mire qe ta dërgoni nje emër si LDK, dhe te krijohet nje fryme e bashkëpunimit sepse ne te ardhmen keni edhe ju gjana qe kërkohet mbështetje me vote, prandaj fryma e bashkëpunimit eshte e domodoshme per funksionimin e rregullte te keti kuvendi komunal.

z.Shpejtim Gacaferi, sipas materialit qe ka ardhe nga MAPL, anulimi i keti vendimi eshte sipas nenit 14, te udhëzimit administrativ, dhe neni 14 ishte pikërisht ajo qe une e kame diskutuar, sepse ne neni 14 thote se ne qoftes se komiteti nuk eshte i parapar ne buxhet nuk keni te drejte te themeloni komitet tjetër, me se paku eshte mos emërtimi i anëtarit te LDK_se, sepse nga kuvendi mungon vetëm nje por nga ana e eksperteve mungojnë dy emran, ate dite ne mbledhje parashturesi i kesaje kerkese z.Jetmir Tofaj ka mare shembull dy komuna qe kane themeluar kete komitet, dhe une kam thene se do ishte mire te meren shembull komunat qe nuk bajne shkelje ligjore e jo te meren shembull ato komuna qe bajne shkelje ligjore.

z.Jetmir Tofaj, e admiroje kete zelle qe te mos ket shkelje ligjore dhe me u ndjek proceduart, do dëshiroja qe kete zelle ta kishit edhe ne formimin e komitetit per komunitete, ku emrat kane shkuar nga ekzekutivi per shoqerin civile dhe te përfaqësuesit te bizneseve, mbeten diskutabile, nuk keni patur diçka kundër deh do ishte mire qe standartet ti ndiqni edhe kure behet fjale per antare te juaj.

z.Burim Kuçi, kryesues ti e sqarove se pse nuk ka kaluar ligjshmerin ky vendim, andaj nëse grupi i LDK_se nuk ka propozim per kete anëtar te keti komiteti atëherë ne e emërojmë kte anëtar dhe vazhdojmë tutje me pikat tjera te rendit te ditës.

z.Jetmir Tofaj, meqene se LDK nuk dëshiron te behet pjese e keti komiteti, atëherë ne si LVV nuk i përkrahim me vote as rregulloren per menaxhimin e mbeturinave, as plotësim ndryshimin e rregullores per gjoba taksa as asgjë tjetër.

z.Burim Kuçi, me qene se LDK nuk propozon antare per kete komitet ne si AAK propozojmë znj.Arlinda Pepshi.

z.Shpejtim Gacaferi, meqë tash po i dimë tre emrat, a mund ti dimë edhe dy emrat tjera qe ta kemi te kjarte se kënd po e votojmë.

z.Jetmir Tofaj, perberaj e keti komiteti eshte ne kete përbërje: znj.Elsa Himaj-LVV, z.Aldi Gacaferi-AAK, znj.Arlinda Pepshi-AAK, znj.Drita Krasniqi dhe znj.Drita Hoxha.

znj.Litafete Isufaj, përshëndetje per te gjithë, këta emrat nga kuvendi po e dimë, por dy emrat nga jasht kuvendi sipas cilit kriter eshte bere përzgjedhja e tyre.

z.Leonard Lolluni, une eges ne votim rishqyrtimin e vendimit, kush eshte per, per 8 vota, kundër, 6 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rishqyrtimi i vendimit me nr:2-180/1638 u miratua.

5. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit të Punës së Kuvendit për Vitin 2026,

Sqarimin dhe arsyetimi e planit te punës se kuvenit per vitin 2026 e beri kryesuesi i kuvendit, z.Leonard Lolluni.

z.Burim Kuçi, a ban me dite se kush ka propozuar qe muaji Gushte te jete pushim per kuvendin.

z.Leonard Lolluni, propozimi ka ardhur nga Kryetati i Komunes por eshë nga une.

z.Bedrush Hoxha, ne mbledhjen e KPF jemi dakorduar qe muaji Gusht te jete pushim, nuk e di pse ky insistim nga ana e z.Burim Kuçi.

z.Jetmire Tofaj, per hire te transparence ju z.Bedrush Hoxha keni qene kundër, mire por shumica kane qene per.

z.Leonard Lolluni, kerkese tjetër nuk ka e qes ne votim plani e punës me ndryshime, kush eshte per, per 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani i punës se kuvendit per vitin 2026 u miratua me ndryshime e kërkuara ne mbledhjen e KPF.

6. Shqyrtimi i Raportit Finaciar për Periudhën Janar-Mars 2026,

Sqarimin dhe arsyetimin e raportit financiar e beri znj.Ardita Hoxha-UD drejtori ne DBF, e cila fillimisht i përshëndeti te gjithë, me pas e sqaroi dhe arsyetoi raportin financiar per perudhen janar-mard 2026 para anetarve te kuvendit.

z.Leonard Lolluni, siç e dini raportet nuk votohen, nëse nuk ka dikush ndonjë kerkese kalojmë ne piken e redhes se ditës.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Inicimir të Procedurave për Plotësim ndryshim të Rregullorës për Taksa Komunale për vitin 2027,

Sqarimin dhe arsyetimin e inicimit te procedurave per plotësim ndryshim te rregullores per taksa komunale per vitin 2027 e beri znj.Ardita Hoaxha-UD drejtori ne DBF.

z.Leonard Lolluni, kerkese nuk ka , e qes ne votim inicimin e procedurave per rregulloren per taksa, kush eshte per, per 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se inicimi i procedurave per ndryshimin e rregullores per taksa komunale per vitin 2027 u miratua.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i Plotësim ndryshimeve të Rregullorës për Menaxhimin e Mbeturinave (leximi i dytë),

Sqarimin dhe arsyetimin e potsim ndryshimit te rregullores e beri z.Demokrat Ganiyaj-UD drejtori ne DSHPMISI, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë, me pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anetarve te kuvendin plotësim ndryshimin e rregullores per menaxhimin e mbeturinave (leximi i dyte).

z.Burim Kuçi, realisht une kam patur dy kerekxa, ne menyre qe ta votoje kete plotësim ndryshim te rregullores per menaxhimin e mbeturinave dhe ne emalin zyrtar me ka ardhur nje email se zyra do te hapet nga 1 Qeshori 2026, po ashtu edhe paga per ata dy puntore do te rritet, kam patur kogja vrejtte per kete rritej prej 1€, mire por une e kame vlersuar ndryshe se përfundimisht nëse diçka eshte bere e mire eshte pikërisht grumbullimi i mbeturinave per këte arsyje edhe do ta përkrahim kete ndryshim te rregullores per menaxhim te mbeturinave.

z.Jetmir Tofaj, u tha se diskutimi publik ka zgjatur 15 dite por nuk eshte pranuar asnjë koment, une edhe ne mbledhjen e KPF_se e kam cekur se publikimi i njoftimit nuk eshte bere ne kanale te duhura, per çdo gjera tjera per rreklamim te punve publikohen ne faqen zyrtare te komunës ne facebook, ndërsa informata per ndegjim publik nuk publikohet, nuk e di se cili eshte qëllimi, po ashtu as ne web-faqe nuk e ka gjetur kete njoftim, dhe une e shohë kete per ti ikur diskutimit publik per ndryshe nuk sho ndonjë arsyje tjetër pse mos te kete publikim per kete njoftim, per ndryshe ne si LVV do te votojmë kundër.

z.Demokrat Ganiyaj, ne kemi vendosur si praktik qe si zakonisht publikimet i vendosim te këndi i njoftimeve ktu para derës se hyrejes se komunës, po ashtu ne web-faqen e komunës eshte e publikuar ndërsa sa i perkete rrejteve socila si qeshte facebook ne si komune asnjë her nuk kemi publikuar njoftme per ndegjime publike te paktën per kete rregullore.

z.Jetmir Tofaj, per kete rregullore ndoshta nuk e keni bere publikomin e njoftimit por per ndegjime publike tjera psh 13 korrik 2023 ndegjim publik ndegjimi i dyte per buxhetin, por per kete rregullore ndoshta nuk e keni publikuar, megjithe ate qëllimi eshte qe qytetaret te keni informate qe eshte ka mbahet nje ndegjime publik per kete qeshtje, e shohë si mundësi te mire dhe nuke e di se pse me ju shmange asaj, eshte e poestuar ne web-faqe qe eshte shume mire, e ke postuar ne këndin e njoftimeve te dera hyrës e komune qe eshte shume mire, herave tjera do ishte mire te postohet edhe ne facebook zyetar te komunës sepse ndoshta aty do te pranoni komente, sepse vet fakti qe nuk ke pranuar komente i bije se qytetaret nuk e kan pare kete njoftim.

z.Ruzhdi Shehu-Kryetar i Komunes se Junikut, sa i perkete kësaj rregulloreje ne kemi pasur takim ne nivel qeveri dhe ne nivel te kryetre komunash, me këto parime qe janë vendosur per ngritjen e çmimit eshte e miratur unanimisht edhe nga kryetar e komunave, nuk ka patur asnjë kundër per shkak se duan te shtojnë kujdes te madhe pastërtisë se qytetit, dhe une besoj se Komuna e Junikut eshte nder ato komuna qe eshte vlersuar ne performance qe ka te beje me nje pasterti dhe higjene jashtezakonisht te mire.

z.Leonard Lolluni, kerkese tjeter nuk ka, ju rikujtoj se ne si AAK kete ndryshim te rregullores e kemi perkrah ne lexim te pare, po ashtu e kemi perkrah edhe ne mbledhjen e fundit te KPF_se, andaj menoj se duhet ta perkrahim te gjithë, e per kete arsyje kerkoj pese minuta pauze, qe ta diskutoj me asamblistet e AAK_se dhe asamblistet e LVV_se, per kete pike te rendi te dites.

z.Bedrush Hoxha, kete ndryshim te rregullore e kemi perkrahe te gjithë ne mbledhjen e KPF_se, mos te mbajme inati ta votojme kete ndryshim te rregullore se nuk ka arsyje tjeter mos votim i saj.

z.Jetmir Tofaj, spo dua, por spo mundem pa fole z.Bedrush Hoxha, jane shume te mire kur eshte qeshtja per veti, por nje pike te rendit te dites me heret tek Komiteti per Arsim, ate inati qe e permende eshte dashur qe ta hekesh ti z.Bedrush Hoxha.

Pauze pese minuta.

Pas pauze.

z.Jetmir Tofaj, ne si LVV, e kemi perkrahe edhe ne lexim te pare kete plotesim ndryshim te rregullores permenaxhim te mbeturinave, po ashtu edhe ne mbledhjen e KPF_se, ideja nuk eshte me e bllokuar, ideja nuk ka qene edhe te votim i bartjes se mjeteve nga viti 2025 ne vitin 2026, sepse e dime borgjin ndaje KESCO, ne vlere prej 23000€, 50000€ kemi votuar bartje, sikur aty te bllokoni e mos ta votoni dhe ato mjete te ktheheshin ne buxhe do ishte mundesia qe sot as keta mikrofone te mos na benin se nuk do kishte rryme, ideja nuk eshte me bllokuar, por ju inkuaroj edhe juve si ekzekutiv, si parti politike LDK, mos me qene as ju bllokuse, ideja eshte ta keminje bashkpunim ne te mire te Junikut, e jo kur te ju vije rasti juaj me thane jemi kunder me nje fjale me u munduar me bllokuar procesin, nuk ecim ashtu, e sidomos kur nuk e keni nje marrveshje politike qe ju garanton shumicen ne Kuvend komunal, une per hire qe ky ndryshim plotesim i rregullores per menaxhimin e mbeturinave eshte i nevojshem, edhe siq e ceki ne sqarim Drejtori se ky ndryshim vije nga vendimi i ministris se ekonomise per rritje te tarifave per deponim te mbeturinave, per kunder qe me pare thash se jame kunder, dhe per hire qe eshte e

nevojshem dhe qytetaret te mos mbesin pa sherbim, po ashtu edhe kerkesa e z.Burim Kuçi, jane miratuar dhe do te implemetohen nga 1 Qeshori, ne ne kete raste e ndryshojme qendrimin dhe vota jone si LVV do te jete per.

z.Leonard Lllolluni, siq e tha z.Jetmir Tofaj, ne si kuvend i junikut duhet te kemi nje fryme bashkepunimi, jo vetem per ate se e ke apo nuk e ke shumicen ne kuvend, mire por kur nje vendim eshte i drejte pa mare parasyshe se sa vota i ke eshte mire me e perkrahe, ne e kemi perkrah ne lexim te pare, ne KPF, kete rregullore, andaj kerkoj edhe nga anetaret e grupit te LDK_se te kemi fryme bashkepunimi se as gjysmen e viti te pare nuk e kemi kaluar,nese ska kerkese tjeter une e qes ne votim plotesim ndryshimn e rregullore per menaxhimin e mbeturinave, kush eshte per, per 14 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plotesim ndryshimi i rregullores per menaxhim te mbeturinave u miratua.

9. Kerkse per vendim per inicim te procedurave per Hartimin e Plani tre Vjeçar për Banim social (2026-2029)

Sqarimin e hartimit te planit tre vjeçare per banim social e beri kryesuesi i kuvendit z.Leonard Lllolluni, i cili pas sqarimin dhe pasi qe nuk pati kerkesa nga ana e anetarve te kuvendi e qit ne votim hartimin e planit tre vjeçar per banim social, per 14 vota, kunder 0 vota she abstenim 0 vota, me kete konstatohet se vendim per inicimin e proceduarve per hartimin e planit tre vjeçare per banim social (2026-2029) u miratua.

10. Te ndryshme.

z.Leonard Lllolluni, para se ta mere fjalen ndonjeri nga ju, ju njoftoje se une kam pranuar nje email nga DEMOS, te cilet monitorojne kuvendet komunale, e kane nje lloje gare, ku perzgjedhin asamblistin me te zeshem te kuvendeve komunale, dhe kane kerkuar qe une ta diskutoj me ju se a pranojme ne te behemi pjese e meti monitorimi, ku do te zgjedhej asamblisti me i zeshem dhe me i arsyshem i kuvendit komunal.

z.Jetmir Tofaj, une pajtohem qe te kete monitorim dhe perzgjedhje te asamblisti me te zeshem ne kuvendin komunal Junik, dhe e konsideroj qe ne si kuvend komunal duhet ta kemi kandidat te perbashket dhe kisha propozuar z.Bedrush Hoxha, si asemblast me te zeshem nese te gjithë pajtoheni.

z.Shpejtim Gacaferi, orgbizata DEMOS, bashkepunojne me HELVTAS e Zvicres, qe fitojne projekte nga MAPL_se per monitorim te komunave permes asocacionit te komunave, komuna e Junikut eshte anetare e asocacionit te komunave, si nag ana e kuvendit ashtu edhe nga ekzekutivi, prandaj skemi çka me diskutira gjate, ne te gjithë jemi te pajtimit per kete monitorim qe pa dyshim shkone ne favor te opozites, po pavarisist kesaj ne si LDK e perkrahim sepse eshte interes i gjithë neve, po ashtu kam nje vrejte per z.Jetmir Tofaj dhe z.Bedrush Hoxha, po me duket se keta te dyte jane duke e kaluar ne personale dhe mendoj se kjo nuk eshte e mire.

z.Leonard Lllolluni, une besoj se keta te dyte jane shoqe, me heret ne pauze ndezen dhe pine cigare bashke.

z.Jetmir Tofaj, shefi i grupit te LDK_se nuk do ishte mire me qene nxites, ne asgje personale nuk kemi, perveq puneve serioze ndonjeher kemi momente te disponushme, dhe apsultisht nuk kemi personale dhe as qe do te kete, ne njerze jemi dhe kanihet duhet te bejme edhe humor.

z.Aldi Gacaferi, pershendetje per te gjithë, i kame dy qeshte, qeshtja e pare ka te beje me ndriqim publ, eshte nje kohe e gjate qe ne qender te Junikut nuk ka ndriqim publik, pse po ndodhe kjo, dërsa qeshtja e dyte ka te beje po ashtu me ndriqim publik, nga lagjeja Agim Ramadani e deri te stacioni i autobusave shume shtylla ndriquse nuk kane drita, po ashtu ne kete segment te rruges me saksisht te pompa e derivateve Zem-Zem eshte nje shtylle qe gati eshte duke ra, po ashtu edhe te lagjeja Miroc ka nje shtylle po ashtu qe eshte duke ra dhe aty ka edhe kamera te sigurise, dhe une nuk kame pare qe eshte ndermare ndonje mase apo diçka e ngjajshme.

z.Ruzhdi Shehu-Kryetar i Komunes junik, sa i perkete ndriqimit ne qender, eshte e vertete qe jane te demtuara per shkat te punimeve, por se shpejti do te kemi nje kontarte per mirembajte te tyre, ndërsa sa i perkete shtyllave ndriquse nga lagjeja Agim Ramadani tek stacioni i autobusave, te gjitha shtyllat kane ndriqim por kemi demtime nga ana e ngasive te veturave, damtusit dihen se kush jane dhe ne kete drejtim shume shpejt do te kete sanimi te tyre dhe shpenzimet do ti bartin te gjithë ata qe i kane demtuar keto shtylla.

z.Burim Kuçi, ne kete pike te ndryshme ne si grupe ne çdo mbledhje te kuvendi kemi parashtruar kërkesa dhe deri tani asnje kërkesë nuk eshte mare per baze, pse po ndodhe keshtu nuk e di, kemi kerkuat qe te riparohet ndriqimi ne lagjen Berishe, prap kerkoj qe te ndermëni masa per kete qeshtje sepse eshte i nevojshem ndriqimi ne ate lagje, qeshtja tjetër ka te beje me kanalizimin e ujrave te zeza te shtepija e Xhemajl Kuçi qeshtje kjo e ngritur edhe me heret dhe ke premtuar se do te sanohet, deri tash nuk keni ndermar asgje, ndërsa qeshtja tjetër ka te beje ne rrugen Ali Salihu ne lagjen Berishe qe eshte asfaltuar tani kerkoj qe ne ate rruge te vendosni pengues te shpejtesis per automjete, sepse ne ate rruge kane dalje disa rruge dhe dukshmeria eshte shume e ulet, por edhe kebsoret jane te rrezikuar sepse rruga eshte e ngushte e vendosje e ketyre pengusve do bente me shume siguri, andaj une kerkoj qe keto kërkesa te meren parasysh se per ndryshenese nuk meren edhe ne dime te veprojme ndryshe ateher kur ju keni nevojë per votat tona.

z.Ruzhdi Shehu-Kryetar i Komunes junik, rruga Ali Salihu ende nuk eshte perfunduar, do te kete ndriqim dhe asfaltim prap dhe do te kete qasje ne rrugen regjionale qe lidhet juniku me fshatrate e “Rekes se Keqe” por po ashtu jane te parapara edhe vendosje e pengesave per shpejtesi te automjeteve, mire por per shkat te kontrates kolektive e cila na ka demtuar shume jo vetem neve si komune por te gjithë komunat, por ne mundesin e pare qe do ta kemi ne do ti fillojme proceduart e prokurikrit dhe do ta perfundojme ate rruge, mire por kjo nuk ndodhe mbrenda nates tjemi te kuptuar, ndërsa sa i perkete kanalizimit te ujrave te zeza te shtepija e Xhemajl Kuçi, ajo eshte ne kuader te mirembajtjes se kanlizimit te ujrave te zeza ne bashkpunim me KRU Hidrodrini, eshte adresuar dhe besoj se shume shpejti do te intërvënojne.

z.Alfred Gaxherri, pershendetje per te gjithë, u tha se te gjitha shtyllat ndriquse funksionojn perpos atyre qe jane demtuar nga ngasit e makonave, kjo nuk qendron sepse ka edhe shtylla tjera qe nuk funksionojne, po ashtu kete qeshtje e kam ngritur edhe ne mbledhjet e me parme kerkjoj qe kjo qeshtje te meret parasysh nga ana e ekzekutivit sepse ka shume ankesa nga qytetaret, ka te beje me pengesat e shpejtesie te vendosura ne rrugen qender ne drejtim te fshatit Dobrosh.

z.Jetmir Tofaj, me ligjin per veteqeverisje lokale, kryetari i komunes eshte organi me i larte i njesis themelore i veteqeverisjes lokale qe njihet si komune ne Republiken e Kosoves, por ne ne komunën tone duhet me e ndrruar orgali me i larte ekzekutiv dhe me bere organi me i larte konstatues, çdo problem qe e sjellim ne ne kuvend, thot se mire e keni do te behet, ne teren asnje veprim duhet proceduar, po ti kryetar ke shume çka tjeter te veprosh pa proceduar, ne ende nuk kemi drejtor te ekonomis te emertuar, jemi me ushtrus detyre, nuke kemi ende ekzekutiv te prezentuar, ndoshta kjo eshte eshe arsyja nuk po e plotesoni kerkesen qe kame qe mbledhja e kuvendit te shfaqet live ne facebook, qe eshte kerkese qe e kame parashtruahar qe tri here dhe nuk po ka zbatim, une nuk e di se çka duhet bere ne si kuvend komnal, a te marim vendim qe te kete transpetim live ne facebook, e ki rregulloren per transparen qe e ke votuar vete vitin e kaluar, pse nuk po e zbaton, pse nuk po e emrton ekzekutivin, nese jane keta ekzistues pse nuk po na prezenton, jane bere mbi 100 dite, pune nuk shihen ne teren dhe kjo eshte me te vertet shqetsuese, edhe per ndriqimin publik qe u fole, projektin kur e keni perfunduar jeni lavduar dhe me te drejte, por sot kemi plote drita qe nuk funksionojne, ato qe jane te demtuara shihen por ka edhe plot tjera qe nuk funksionojne, nese jeni duke e kursy rrymen eshte ne rregull por me than se punojn te gjitha perpos te demtuarve kjo nuk eshte ne rregull.

z.Ruzhdi Shehu-Kryetar i Komunes Junik, qeshtja e ndriqimit edhe nje here, ka shume shtylla qe jane demtuar siq e thash dhe ato shtylla fo te snaohen nga demtuesit, por ne anen tjeter jemi ka mundohemi edhe me e kursy energjine sepse fatura po vije shume e larte dhe ne kete drejtim une besoj se do te kete shume shpejt te alukim te mjeteve dhe me perkrahje edhe nga ministrin dhe qeveria ne menyre qe te fillojme me proceduar e mirembajtjen e ndreqimit publik, po ashtu do ti eliminojme edhe ato pengesa qe eshte ngritur si qeshtje nga z.Alfred Gaxherri.

z.Jetmir Tofaj, keto pune i ke ditur besoj kur e ke bere programin qeveritar ne fushaten zgjedhore ne vlere prej 100000000€ dhe me investime te huaj kjo ngritet ne 500000000€, a e ke patur informaten per kontraten kolektive kur i ke bere premtimet, e tejkalojme kete, por a mundesh se paku ekzekutivin me e perfundu dhe me na e prezentuar ketu ne kuvend dhe me than se ky eshte ekzekutivi.

z.Ruzhdi Shehu-Kryetar i Komunes junik, shume shpejt do te ju njoftoj, jemi duke punuar ne kete drejtim, mire por edhe keta qe jane, jane duke punur jane te angazhuar detyrat jane duke i kryer.

z.Demokrat Ganiqaj, une fillimisht e shfrytezoi rastin me i falemenderuar per votimin e ndryshimeve te rregullores per menaxhimin e mbeturinave, ndersa sa i perkete qeshtjeve qe u ngriten per ndriqim publik, kemi afer dhejte shtylla te ndriqimit publik qe jane demtuar dhe jane ne proceduar per riparim ne mese komues si njesi dhe kompanis se sigurimeve ku ne si komune kemi bere ankesa sepse vlere qe kan prezentuar agjensija e sigurimit nuk ka qen reale dhe tani kjo anekesa i ka 30 dite per tu shqyrtuar dhe kjo po na shkakton vonesa, ndersa sa i perkete disa

shtyllave qe nuk jane duke funksionuar ne rrugen kryesore, kemi marylara masa qe te kete kursim te shpenzimit te energjise ashtu siq e tha edhe kryetari, ndersa sa i perkete ndriqimit ne qender ne e kemi thirrur kompanin dhe gjate dites eshte interesane qe dritat funksionojne ndersa gjate territorit nuk po funksionon, dhe si perfundim kemi ardhur ne ate se ndoshta gjate nates kemi kyqje nga ndokushe ne kete rrejt e kjo e pamundson funksionimin e dritave, dhe ne e kemi ftuar prap kompanin qe te beje kontrollin e seciles shtylle ne menyre qe te gjindet problemi, ndersa sa i perkete rretit ne lagjen berishe, ky rrejt eshte i lidhur ne qarkoren e ri te rretit dhe kutija aty e sistemit smart dhe eshte nengarncion prej kompanise qe e ka nderuar, ne e kemi njoftuar kompanin dhe na kan premtuar se do te vine per ta ndrruar, dhe ne nuk kemi mundur te reagojme per shkak te garancionit qe ka kjo kuti.

znj.Blerita Syla, pershendetje per te gjitha, qeshtaj ka te beje, te rruga Avdi Goçi, ndriqimi publik eshte i pjesisht dhe une kerkoj qe kjo rruge te kete ndriqim te plote.

z.Leonard Llojuni e shpalli te mbyllur mbledhjen e Prill-2026

Procesmbajtësi:
z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Llojuni
